

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË AFATMESME TË TË ARDHURAVE DHE PLANIT TË VEPRIMIT, 2024-2027”

I. QËLLIMI I PROJEKT-AKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektakti ka qëllim miratimin e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave (SAA) dhe Plann e saj të Veprimit, për periudhën 2024-2027.

Miratimi i këtij projektvendimi është i domosdoshëm dhe mundëson reformat në fushën e politikave tatimore, administrimit tatimor e doganor që parashikohen të ndërmerren gjatë kësaj periudhe katërvjeçare, me synim, rritjen e të hyrave në buxhetin e shtetit nga sistemi tatimor, përmirësimin e efektivitetit në punën të administratës tatimore dhe doganore, si elementë të rëndësishëm për konsolidimin e financave publike.

II. VLERËSIMI I PROJEKT-AKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektakti i hartuar është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) 2023-2030, Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2025-2027, Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) 2023-2030, dokumentin e Programit të Reformave Ekonomike (ERP), Axhendën e Reformave të Shqipërisë në kuadër të Planit të Ri të Rritjes së Komisionit Evropian për Ballkanin Perëndimor dhe Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë Nëntor 2023.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKT-AKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Zbatimi i kësaj strategjie do të udhëhiqet nga parimet e ruajtjes së stabilitetit makroekonomik dhe financiar, respektimit të rregullave fiskale, transparencës së plotë me publikun dhe komunikimit e koordinimit të ngushtë me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit.

Përgatitja e dokumentit të Strategjisë Afatmesme e të Ardhurave (SAA) ka si qëllim mobilizimin e të ardhurave përmes politikave të qëndrueshme fiskale dhe reformave administrative tatimore e doganore, duke thjeshtuar procedurat, kostot e pajtimit, luftën ndaj shmangieve dhe evazionit tatimor, me qëllim krijimin e hapësirave fiskale për më shumë investime dhe zhvillim të qëndrueshëm, përfshirë shëndetësinë, arsimin, mbrojtjen sociale dhe infrastrukturën.

Nëpërmjet kësaj Strategjie, synohet që, në vitet në vijim, vendi ynë të përmirësojë raportin "Të ardhura tatimore/PBB-së" duke ju afruar nivelit mesatar të vendeve të Ballkanit Perëndimor, vende me të cilët kemi ende diferencë në efektivitetin e mbledhjes së të ardhurave.

Strategjia Afatmesme e të Ardhurave dhe Plani i Veprimit, 2024-2027, paraqet të detajuara reformat që do të ndërmerren në politikatat tatimore, mirëadministrimin tatimor dhe doganor, të cilat së bashku parashikohet se do të sjellin rritje të të ardhurave tatimore me 2.5% e Produktit të Përgjithshëm Bruto (PBB) për periudhën katërvjeçare.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projekti paraqitet në përputhje me parimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së projektakteve. Projektvendimi është në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKT-AKTET NORMATIVË)

Projektakti nuk synon përafrimin me legjislacionin e BE-së, por adreson rekomandimet e dhëna na BE në Progres Raportin vjetor për Shqipërinë të nëntor 2023 lidhur me hartimin e SAA.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT-AKTIT

Nevoja për një Strategji gjithëpërfshirëse të rritjes së të ardhurave të buxhetit është identifikuar herët dhe në vitin 2019, Ministria e Financave, e mbështetur nga asistenca e FMN identifikoi masat konkrete të politikës fiskale dhe mirë-administrimit tatimor e doganor, të cilat duhej të

Relacion për projektvendimin "Për miratimin e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave dhe Planit të Veprimit, 2024-2027"

ndërmerreshin në vitet në vijim, me qëllim që sistemi tatimor të garantonte gjenerimin e të ardhurave shtesë për mbulimin e shpenzimeve buxhetore. Për arsye të impaktit negativ në ekonomi në vitet 2019-2021 të ngjarjeve dhe situatave të paparashikuara (pasojat e tërmetit 2019 dhe të pandemisë covid-19), zbatimi i masave të dizenuara në fushën e politikave tatimore filloi të materializohej në vitin 2022 dhe më tej në vitin 2023.

Nga Janari i vitit 2022, Shqipëria ka filluar zbatimin e masave të parashikuara në draft Strategjinë Afatmesme e të Ardhurave (SAA). Pavarësisht se situata ekonomike e pafavorshme e vitit 2020, si rezultat i mbylljes së ekonomisë për shkak të Covid-19 reduktoi të ardhurat e buxhetit me 1 % të PBB-së, si rezultat i masave të ndërmarra në vijim, sidomos në fushën e politikave tatimore, rikuperimi ishte i shpejtë dhe të ardhurat tatimore në vitin 2023 janë rritur me +0.7 % e PBB-se krahasuar me vitin 2019, dhe në vitin 2024 parashikohet se do arrijnë në 26.7 % e PBB-se, nga 25.2 % në vitin 2019.

Zbatimi i masave të politikës fiskale sipas Rekomandimeve të FMN

Zbatimi i masave të politikës fiskale sipas Rekomandimeve të FMN, masa të cilat u detajuan në draft Strategjinë e të Ardhurave sipas viteve, ka nisur me “Paketën Fiskale 2022”, dhe ka vazhduar me “Paketën Fiskale 2023” dhe “Paketën fiskale 2024”. Ndryshimet e ndërmarra në fushën e politikave dhe administrimit fiskal kanë synuar zgjerimin e bazës së tatimit, reduktimin e incentivave fiskale, shfuqizimin e tarifave tatimore të reduktuara dhe atyre preferenciale. Ndryshimet e realizuara përfshijnë legjislationin e tatimeve indirekte (akcizat dhe TVSH-në), si dhe tatimet direkte mbi të ardhurat e entiteteve dhe personave fizikë. Së fundi u miratua Ligji i ri “Për tatimin mbi të ardhurat” i cili zgjeron bazën e tatimit, si dhe shfuqizon tarifën e reduktuar tatimore për industrinë e IT, nga 1 janar 2026.

Për periudhën afatmesme, 2024-2027, të ardhurat totale të buxhetit parashikohet të rriten me +2.5% e PBB në krahasim me vitin 2023. Reformat e parashikuara për periudhën 2024-2027 synojnë:

- të thellojnë më tej reformat në fushën e politikave dhe sidomos në drejtim të administrimit tatimor e doganor, duke bërë të mundur rritjen e neutralitetit të sistemit tatimor, eliminimin e deformimeve të krijuara në sistem, përmirësimin e nivelit të normave tatimore dhe rritjen e bazës së tatimit.
- të shërbejnë si një guidë e rëndësishme në vendimarrjen politike në lidhje me politikat fiskale të vendit, si dhe në vendimarrjet e operatorëve ekonomikë në lidhje me strategjitë e biznesit, të cilat kërkojnë qëndrueshmëri në politikat fiskale me qëllim programimin e veprimtarisë dhe aktiviteteve në terma afatgjatë.

- t'i ofrojnë qeverisë një pasqyrë të qartë të nivelit të të ardhurave tatimore të pritshme në secilin vit të kësaj periudhe 4 vjeçare,
- t'i ofrojnë operatorëve ekonomikë pamje të qartë dhe mbi të gjitha më shumë siguri, mbi mënyrën se si do të trajtohen dhe cilat do të jenë detyrimet tatimore në lidhje me vendimet që do ndërmarrin për investimet e tyre.

Për të ardhurat tatimore të cilat përfshijnë: (i) të ardhurat tatimore nga tatimet dhe doganat; (ii) të ardhurat nga taksat vendore, dhe (iii) të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, në Strategji janë programuar një sërë masash të ndara në tre shtylla kryesore:

Shtylla 1: Rishikimi i politikës tatimore

1. Rishikimi i politikës tatimore të tatimeve mbi konsumin;
2. Rishikimi i politikës tatimore të tatimeve dhe taksave direkte;
3. Rishikimi i politikës tatimore të taksës mbi pasuritë e paluajtshme.

Shtylla 2: Mirëadministrimi tatimor

1. Zvogëlimi i hendekut të pajtueshmërisë në lidhje me TVSH-në;
2. Ulja e pagesave me para në dorë në ekonomi;
3. Verifikimi i të ardhurave dhe kontrolli i pasurive të pajustificuara;
4. Zvogëlimi i shmangies tatimore;
5. Reduktimi i punës së padeklaruar dhe të nëndeklarimit të pagës reale;
6. Reduktimi i kostove të pajtueshmëris dhe rritja e sigurisë tatimore dhe besimit tek administrata tatimore;
7. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga Administrata Tatimore (AT) nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve institucionale të administratës tatimore.

Shtylla 3: Mirëadministrimi doganor

1. Modernizimi i proceseve të biznesit, duke përfshirë centralizimin e funksionit të profilizimit të riskut;
2. Zhvillimi i aftësive të zgjeruara analitike të të dhënave;
3. Rritja e investimeve në zhvillimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit;
4. Zhvillimi dhe zbatimi plotësisht i një kornizë integriteti për të ndihmuar në ndërtimin e besimit të komunitetit;
5. Rritja e numrit të operatorëve ekonomikë të autorizuar;
6. Zbatimi i Dritares së Vetme Kombëtare (National Single Window);
7. Përmirësimi i përdorimit të Sistemit të Ri të Kompjuterizuar të Transitit (NCTS);
8. Rritja e bashkëpunimit në luftën kundër informalitetit, kontrabandës, korrupsionit dhe importit të mallrave të falsifikuara;

9. Zgjerimi i shkëmbimit të informacionit me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë për të përmirësuar profilin e riskut.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E AKTIT.

Për zbatimin e këtij projektakti ngarkohet Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si dhe institucione për disa masa për të cilat administrata fiskale do të bashkëpunojnë në realizimin e tyre si : ISSH, AKEP, Ministria e Turizmit.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE PERSONAT DHE QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT

Në Prill 2024, me Urdhër të Ministrit të Financave, Urdhri i Ministrit Nr. 47, datë 15.04.2024 “Për ngritjen e Grupit të Punës dhe Sekretariatit Teknik për hartimin e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave 2024-2027, në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar” u ngrit Grupi Teknik i Punës dhe Sekretariati Teknik i cili në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar punoi hartimin e kësaj Strategjie.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Të ardhurat shtesë në buxhet

Ky projektakt shoqërohet me rritjen e të ardhurave shtesë që do të hynë në buxhetin e shtetit për një periudhë 4-vjeçare, rreth 64,858 milion lek sipas parashikimit më poshtë.

SAA ka tre shtylla me komponentët përkatës që parashikohet se do të gjenerojnë të ardhura shtesë në buxhet si vijon:

1. Shtylla 1: Rishikimi i politikës tatimore me 3 komponentë, nga e cila do të ketë rritje të të ardhurave tatimore 0.34% e PPB ose 9.28 miliardë lek;
2. Shtylla 2: Mirëadministrimi tatimor me 7 komponentë, nga e cila do të ketë rritje të të ardhurave tatimore me 1.97% e PPB ose rreth 51 miliardë lek;
3. Shtylla 3: Mirëadministrimi doganor me 9 komponentë, nga e cila do të ketë rritje të të ardhurave doganore 0.17% e PPB ose 4.5 miliardë lek.

në % të PPB

Shtyllat e Strategjisë	2024	2025	2026	2027	Totali 2024- 2027
Shtylla 1: Rishikimi i politikës tatimore	0.04%	0.03%	0.04%	0.23%	0.34%
Shtylla 2: Mirëadministrimi tatimor	0.68%	0.54%	0.37%	0.38%	1.97%
Shtylla 3: Mirëadministrimi doganor	0.05%	0.06%	0.04%	0.02%	0.17%
Totali	0.77%	0.62%	0.45%	0.63%	2.48%

në milion Lekë

Shtyllat e Strategjisë	2024	2025	2026	2027	Totali 2024- 2027
Shtylla 1: Rishikimi i politikës tatimore	1,010	800	1,000	6,473	9,283
Shtylla 2: Mirëadministrimi tatimor	16,577	13,755	10,069	10,665	51,067
Shtylla 3: Mirëadministrimi doganor	1,265	1,408	1,171	664	4,508
Totali	18,852	15,963	12,240	17,802	64,858

Kostimi

Kosto e SAA është 7,698,054 Euro, nga të cilat 409,747 euro janë kosto buxhetore dhe 7,288,307 euro janë financim nga donatorët. E detajuar siaps shtyllave, kostot janë:

- 14,500 Euro kosto e masave të zbatimit të Shtyllës 1 “Rishikimi i politikave tatimore”, për komponentin e asistencës teknike nga pala suedeze për taksën e pasurisë. Nuk ka kosto buxhetore dhe
- 100,000 euro nga zbatimi i Shtyllës 2 “Mirëadministrimi tatimor” që është asistencë suedeze për hartimin e strategjisë së tatimpaguesve dhe fuqizimi i qendrës së thirrjeve
- 7,583,554 Euro është kosto e zbatimit të masave të përcaktuara nën Shtyllën 3 “Mirëadministrimi Doganor”. Nga totali, shumën prej 409,747 Euro është shumën e buxhetuar nga administrata doganore për vitet 2024-2026 dhe pjesa tjetër është financim nga donatorët për ndërtimin e sistemeve IT.

Këto kosto janë të njëjta me kostot e vëna tek Strategjia e Financave Publike.

Relacion për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave dhe Planit të Veprimit, 2024-2027”

Në euro

Nr.	Titulli	Kosto Totale Indikative		
		PBA	Financim nga Donatorët	Kosto totale
1	Qëllimi i Politikës (Shtylla) 1: Rishikimi i politikës tatimore		14,500	14,500
2	Qëllimi i Politikës (Shtylla) 2: Mirëadministrimi tatimor		100,000	100,000
3	Qëllimi i Politikës (Shtylla) 3: Mirëadministrimi doganor	409,747	7,173,807	7,583,554
	Kostoja Indikative e Strategjisë	409,747	7,288,307	7,698,054

Disbursimi nga BE

Hartimi dhe miratimi i kësaj strategjie brenda muajit Dhjetor 2024 përbën një parakusht që Shqipëria duhet ta plotësojë në kuadër të dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027”, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor”. Miratimi i kësaj strategjie është kusht për disbursimin e 5,977,866. euro nga BE.

**PROPOZUESI
MINISTËR I FINANCAVE**

Petrit Malaj